

See discussions, stats, and author profiles for this publication at: <https://www.researchgate.net/publication/321529719>

# SELMAN RIZA PËR MODALITETIN E FOLJEVE MODALE

Conference Paper · December 2017

---

CITATIONS

0

READS

4,308

1 author:



Vjosa Hamiti

University of Prishtina

28 PUBLICATIONS 5 CITATIONS

SEE PROFILE

**UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
FAKULTETI I FILOLOGJISË**

**dhe**

**UNIVERSITETI I TIRANËS  
FAKULTETI I HISTORISË DHE I FILOLOGJISË**

---

**SEMINARI NDËRKOMBËTAR PËR GJUHËN, LETËRSINË DHE  
KULTURËN SHQIPTARE**

---

**Materialet e punimeve të Seminarit XXXI Ndërkombëtar për Gjuhën,  
Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare  
Prishtinë, 13-25 gusht 2012**

**Vjosa HAMITI**

## **SELMAN RIZA PËR MODALITETIN E FOLJEVE MODALE**

### **1. Hyrje**

Gjatë punimit të magjistraturës “Analizë kontrastive e foljeve modale të gjuhës shqipe dhe gjuhës gjermane, por edhe gjatë punimit të doktoraturës “Modaliteti epsitemik- mundësitë e shprehjes së tij në gjuhën gjermane dhe ekuivalentet në gjuhën shqipe” kam trajtuar dhe shtjelluar gjerësisht modalitetin e pjesëve të ligjëratës të gjermanishtes, por edhe të gjuhës shqipe. Interesi im i shtuar për foljet modale ka të bëjë para së gjithash me rolin shumë të rëndësishëm që kjo kategori e foljeve ka luajtur dhe luan akoma në këtë fushë. Kështu, edhe në këtë punim, do të shkojë më tej interesi im për foljet modale, por këtë herë duke u ndalur në një përshkrim të detajuar të studimit të foljeve modale nga gjuhëtari Selman Riza, sidomos për modalitetet që shprehen përmes tyre. Në fund do të paraqitet folja modale e gjuhës gjermane **KÖNNEN**, ekuivalentja e së cilës në gjuhën shqipe është **MUNDEM**. Interesimi im do të ndalet edhe në përdorimin e tyre me këto dy modalitete.

### **2. Foljet modale të gjuhës shqipe**

Foljet gjysmëndihmëse<sup>1</sup> modale në gjuhën shqipe janë foljet të cilat shprehin modalitetin apo ndryshe qëndrimin e folësit, apo edhe shkruarit ndaj veprimit, të cilin e tregon folja kryesore. Foljet e mirëfillta modale të gjuhës shqipe janë: *mund*, *duhet* (*ose lipset*) dhe *do*. Folësi, i përdor foljet modale, sigurisht me një qëllim të caktuar, i cili ka të bëjë me dëshirën e folësit për të shprehur mendimin e tij se veprimi ose gjendja (e cila pra tregohet me foljen kryesore) është i mundshëm për t’u realizuar, është i detyrueshëm, i lejueshëm, i domosdoshëm etj. Foljet modale në

---

<sup>1</sup> Bucholz, O. / Fiedler, W.: *Albanische Grammatik* 987:60”Foljet gjysmëndihmëse paraqiten në ndërtime, të cilat në shkallë të ndryshme janë të morfologjizuara. Ato me një folje të plotë formojnë një njësi semantike, mirëpo tipologjikisht nuk janë të lidhura me to: Foljet modale: d.m.th. janë folje të cilat sinjalizojnë modalitete të veçanta (lidhorja, paskajorja e gegnishtes, paskajorja e ashtuquajtur, P.sh. Des Müssens (Nezessitativ është/mbetet/bëhet + paskajorja e ashtuquajtur, des wollen (Voitativ, Des Könnens (Possibilitativ) des Zögerns oder der Furcht, der Disposition (Vjen= paskajorja e ashtuquajtur).

gjuhën shqipe, nuk përdoren si folje të veçuara, por gjithmonë të shoqëruara me një folje, e cila zakonisht është në mënyrën lidhore, ndërsa shumë më rrallë folja shoqëruese është në formë të pashtjelluar. Po ta shohësh nga pikëpamja leksikore, folja modale, e cila morfologjikisht nuk mund të quhet e tillë nëse nuk shoqërohet me një folje në lidhore apo në formë të pashtjelluar, në një togfjalësh të tillë nuk merr kuptim të pavarur leksikor. Nga pikëpamja sintaksore ajo nuk e luan funksionin e kallëzuesit në një fjali, por është folja e mënyrës lidhore apo e një forme të pashtjelluar ajo që ka kuptim të plotë leksikor, ndërsa po ashtu e luan edhe rolin e kallëzuesit në fjali. Sa i përket aspektit morfologjik, foljet modale përdoren kryesisht në kohën e tashme dhe gati gjithmonë në vetën e tretë njëjës. Kjo nuk vlen për foljet kryesore që në mënyrën lidhore pasojnë foljet modale, pasi ato zgjedhohen, duke iu nënshtruar kështu të gjitha kategorive gramatikore të foljes, çka do të thotë se përdoren në të gjitha kohët, vetat, diatezat dhe po ashtu në dy numrat.

### 3. Foljet modale sipas Selman Rizës

Gjuhëtarët, apo specifikisht ata që kanë hartuar apo kanë marrë pjesë në hartimin e gramatikave të gjuhës shqipe bien të gjithë në një mendje kur thonë se gjuha shqipe ka vetëm tri folje të mirëfillta modale, ndërsa sikurse në gjuhën gjermane edhe në gjuhën shqipe, nuk mungojnë foljet që reflektojnë vlerë apo nuancim modal. Përjashtim të vetëm bëjnë Newmark L., Prifti, P., Hubbard, Ph Prifti<sup>2</sup>, të cilët e përjashtojnë foljen *do* nga grupi i modaleve. Bahri Beci<sup>3</sup> nga ana tjetër i quan *folje modale* dhe i trajton gjerësisht *mund* dhe *duhet*, mirëpo sipas tij folja modale *do* përdoret në gjuhën e folur dhe tregon detyrim<sup>4</sup>.

Në vitet e 60-ta Selman Riza në studimin monografik “Sistemi foljor i letrarishtes shqiptare bashkëkohore”, i cili fatkeqësisht, për shkaqe të njohura, u botua tridhjetë vjet më vonë, për herë të parë në literaturën shqiptare foljet modale, sidomos modalitetet e ndryshme, i bën objekt studimi.

Riza këto folje i quan *folje të pavetmjaftueshme*, të cilat nuk kanë kuptim të plotë leksikor në vete. Riza përshkruan mënyrën e trajtimit dhe emërtimin e këtyre foljeve në praktikën gjuhësore të vendeve evropiane: këto folje nga gjermani W. Jung quheshin “*foljet ndihmëse mënyrore*”; nga rusi A. N. Gvozdev quheshin “*folje çfaqëse të mënyrorësisë*”, kurse nga francezi A. Dauzat quheshin “*ndihmëse sekondare (të rastit)*”<sup>5</sup>

<sup>2</sup> Newmark L., Prifti, P., Hubbard, Ph. *Standard Albanian*, 1982:106 Sipas tyre gjuha shqipe ka vetëm dy folje modale: *mund* dhe *duhet* (apo *lipset*)

<sup>3</sup> Beci, B.: *Gramatika e gjuhës shqipe* 2005: 159

<sup>4</sup> Beci, B.: *Gramatika e gjuhës shqipe* 2005: 161

<sup>5</sup> Riza, S.: *Libri 13- Vepra 2* 1997: 89

Riza jep edhe një propozim për emërtimin e këtyre foljeve të cilat sipas tij duhej të quheshin “*folje të pavetmjaftueshme marrëdhënore*”. Ai i pagëzon kështu foljet modale, pra të **pavetmjaftueshme marrëdhënore**, pasi konstaton se foljet e këtilla nuk mund të jenë gjysmëndihmëse dhe as modale, sepse nuk shfaqin ndonjë mënyrë zhvillimi të foljes me të cilën shoqërohen. Ato në fakt shfaqin vullnetin, aftësinë dhe nevojën për t’u realizuar veprimi i foljes kryesore, i cili është hëpërhë si diçka materialisht i zbatueshëm. Foljet *mund*, *duhet* dhe *dua* shfaqin vullnetin, aftësinë dhe nevojën jo në vetvete dhe për vetveten, por në lidhje e marrëdhënie me një fenomen të dytë, i cili hëpërhë është i menduar dhe shndërrimin e të cilit në një fenomen efektiv, foljet modale e paraqesin si të vendosur, të mundshëm a të duhur.

Mirëpo propozimi i Selman Rizës për këtë emërtim nuk u përfill nga hartuesit e gramatikave të gjuhës shqipe që pasuan me tutje. Në Gramatikën e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë<sup>6</sup> foljet e tilla u quajtën *folje me vlerë modale*.

#### 4. Aspekti leksikor dhe sintaksor i foljeve modale sipas Rizës

Thamë se foljet *mund*, *duhet* dhe *do* në gjuhën shqipe janë folje modale. Përdorimi i tyre me kuptim të plotë leksikor në shqipen e sotme, gjithmonë bëhet fjalë për gjuhën e standardizuar, është zbehur dhe rrudhur së tepërmi. Mëvetësia e tyre si folje të plota, veçmas e foljeve *duhet* dhe *do*, ka filluar të humbasë me kohë<sup>7</sup>. Pra, këto folje, duke iu nënshtruar një procesi ndërrimesh dhe ndryshimesh gjuhësore, me kohë e kanë humbur kështu pavarësinë e tyre si folje të plota, për t’u “ngurtësuar” të themi kështu, në gjuhën standarde si folje modale. Pra, në fjali, në kuptimin e tyre modal, këto folje nuk mund të përdoren të pavarura, pra si folje të plota, por gjithmonë në togfjalësha, të shoqëruara nga folje të plota në mënyrën lidhore apo edhe (më rrallë ndeshet kjo formë) folje të formës së pashtjelluar.

Lidhur me aspektin leksikor të foljeve modale, Selman Riza<sup>8</sup> thotë: “*Në planin leksikor, këto folje çfaqin koncepte psikologjiko-moralë praktikisht materialo-objektive nga më të përgjithshëmit, siç janë: koncepti i të dashurit (në kuptimin jo të dashurisë, por të dashjes a vullnetit); koncepti i të mundurit (në kuptimin jo të mposhtjes së kundërshtarit në ndeshje, por të aftësisë fizike apo mendore prat. të mundshmërisë objektive); koncepti i duhurisë morale, i detyrimit*

<sup>6</sup> ASHSH: *Gramatika e Gjuhës Shqipe I* 1995: 262, ku thuhet se këto folje shërbejnë për të shprehur modalitetet. Spjegimi për modalitetin shënohet në fusnotë: “*Me termin modalitet kuptohet të shprehurit e qëndrimit të folësit ndaj asaj që kumton, në lidhje të ngushtë me realitetin objektiv. Ky qëndrim i folësit mund të shprehet me mjete të ndryshme gjuhësore: më anë të mënyrave të foljes, me anë të foljeve me vlerë modale, më anë të pjesëzave modale.*”

<sup>7</sup> Karapinjalli, M., “Seminari ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare, 21/2”, 2003: 329

<sup>8</sup> Riza, S.: *Libri 13-Vepra 2*, 1997: 89

*shoqëror apo i nevojshmërisë objektive; koncepti i të lënit (në kuptimin jo të mosmarrjes me vehte, por të të mospenguarit prkt .të të lejuarit”.*

Në aspektin sintaksor foljet modale nuk e kryejnë funksionin e kallëzuesit në fjali. Përkundrazi këtë funksion e kryen folja e plotë që e shoqëron në togfjalëshin të themi modal. Lidhur me ndërtimin sintaksor të këtyre foljeve , Selman Riza thotë<sup>9</sup>: “Në sintaksë, kallëzuesit e ndërtuar me këto folje janë të pavetmjaftueshëm. Prandaj secila prej këtyre foljeve plotësohet nga **një fjali e mvarur**, e cila kundrejt foljes së plotësuar luan rolin e kundrinës së drejt prkt. të kryefjalës psh.

“Unë **due me shëtitë**” ose “unë **dua të shetit**”; “ti **mundesh me shetitë**” ose “ti **mund të shetitësh**”; “ai **duhet me shetitë**” ose “ai **duhet të shetitë**”; ajo më **le me shetitë**” ose “ajo më **le të shetit**” etj.”

Meritë e Rizës është se, i shndërroi foljet modale apo edhe ato me nuancim modal në objekt studimi edhe sa i përket aspektit leksikor dhe atij sintaksor.

## **5. Riza dhe përdorimi me modalitetin epistemik dhe joepistemik i KÖNNEN/ MUNDEM**

Modaliti epistemik shpreh mënyrën, se si folësi sillet apo qëndron ndaj veprimit të përshkruar, sidomos vlerësimi ndaj realitetit të këtij veprimi p.sh. supozime apo mendime të huaja Në gjuhën shqipe këto shprehen kryesisht përmes mënyrave të foljes (kushtorja (1), habitorja (2),dëshirorja (3) dhe urdhërorja (4), që Riza i emërton **mënyra foljore joobjektive**)

(1) *Nëqoftëse ndodh gjë, **duhet t’i** paguajmë faturat familjes, tha gjenerali<sup>10</sup>.*

*(Jemi të detyruar që ta paguajmë nëse ndodh gjë).*

(2) *”Gatishmëria jote ma mbush zemrën me gëzim, por thuamë, si **qenkësh** e mundur kjo? Si **paskësh** mundësi që mësimi i Gotamës, qysh përpara se ne ta dëgjojmë atë, të na ketë dhuruar, tashmë, më të mirin fryt?”<sup>11</sup>*

(3) *“Ashtu **qoftë**, o mësuesja ime! Gjithmonë të **pëlqeftë** vështrimi im më **ndjektiv** gjithmonë prej teje fati i bardhë!”<sup>12</sup>*

(4) *Tani **duhet të gjendet** nëse ka gjë. (tani është e domosdoshme të gjendet)<sup>13</sup>*

Selman Riza pas tejpagëzimit të foljeve modale në *folje të pavetmjaftueshme marrëdhënore* thotë:

*Në dritë të këtij tejkonceptimi dhe tejpagëzimi do të mund të shpjegohej edhe analogjia funksionale e foljeve “**ndihmëse mënyrore**” me natyrën e mënyrave foljore **jo-objektive** siç janë kushtorja, urdhërorja, lidhorja .*

<sup>9</sup> Riza,S.: *Libri 13-Vepra 2*, 1997: 89

<sup>10</sup> Kadare.I : *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, 1980:183

<sup>11</sup> Hesse, H.:*Siddharta*, 2005: 23

<sup>12</sup> Hesse, H.:*Siddharta*, 2005: 52

<sup>13</sup> Kadare.I : *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, 1980:30

*Edhe më të vërtet, këto mënyra foljore t'egzistencës jo-objektive, në vendë që të çfaqin gjithashtu marrëdhënie të këtij fenomeni si diçka vetëm e menduar me të njëjtin fenomen si diçka objektivisht ekzistuese.*

*Ja sepse i tërë ndryshimi midis foljeve ndihmëse mënyrore dhe mënyrave foljore të egzistencës jo-objektive- praktikisht qëndron vetëm këtu që funksionet, të çfaqur leksikalisht nga të parat faqen gramatikisht nga të dytat.<sup>14</sup>*

Kjo tregon se Riza qysh atëherë pati vërejtur modalitete të ndryshme të foljet modale. Sipas kësaj del, që funksionet e modalitetit jo-objektiv shfaqen leksikisht përmes foljeve ndihmëse mënyrore, kurse gramatikisht nga mënyra foljore të egzistencës jo objektive (kushtorja, habitorja dhe urdhërorja) që në gjuhën gjermane shprehen përmes modalitet epistemik.

Duke pasur parasysh këtë, në vijim në këtë analizë kontrastive të shkurtë do t'i paraqes foljet modale të gjermanishtes dhe shqipes *können dhe mund* në përdorimin e tyre me modalitet joepistemik dhe epistemik. Shembujt janë paraqitur nga gjuha gjermane në gjuhën shqipe dhe anasjelltas.

### **5.1. Përdorimi i foljeve modale können dhe mund me modalitet joepistemik**

Kjo folje e ka gjeqjësën në gjuhën shqipe dhe mund të thuhet se te këto dy folje ekziston një përputhshmëri e plotë. Këto folje kanë si kuptim kryesor në të dy gjuhët mundësinë:

- (1) *Ich kann nicht mehr weiter schreiben...mir ist so dumpf im Kopfe... die Glieder tun mir weh.....<sup>15</sup>*
- (1.a) *Nuk mund të të shkruaj më...koka më është turbulluar...gjymtyrët më dhembin.....<sup>16</sup> ( nuk ka mundësi të shkruaj më tutje.)*

Edhe në përkthimin nga gjuha shqipe në atë gjermane ka përputhshmëri të plotë.

- (2) *Ai ishte kryesori dhe mund të hapte çfarë bisede që të donte: për konjakët, kryeqytetet, cigaret. (ai ka mundësi ...ai mundet që të hapë çfarëdo bisede)<sup>17</sup>*
- (2.a) *Er är die Hauptperson, und als solche konnte er nach Belieben die Gesprächsthemen betimmen: Kognaksorten, Hauptstädte, Zigarettenmarken.<sup>18</sup>*

<sup>14</sup> Riza, S.: *Libri 13- Vepra 2*; 1997: 90

<sup>15</sup> Zweig ,S.: *Briefe einer Unbekannten*, 1996: 197

<sup>16</sup> Zweig , S: *Letra e një të panjohure* 1989: 328

<sup>17</sup> Kadare.I : *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, 1980:24

### **aftësi (dhunti)**

- (3) *Nur einsame Kinder können ganz ihre Leidenschaft zusammenhalten:die andern zerschätzen ihre Gefühle in Geselligkeit,..*<sup>19</sup>
- (3.a) *Vetëm fëmijët e vetmuar mund ta ruajnë të gjithë pasionin e tyre: të tjerët i nxjerrin të gjithë pasionin e tyre,...*<sup>20</sup>
- (4) *Unë mund të fitoja me ta shumë beteja*<sup>21</sup>.
- (4.a) *Ich hätte mit ihm viele Schlachten geëinnen können..*<sup>22</sup>

### **Lejim**

- (5) *Aber Du fragst mich vielleicht, wie ich das Kind so im Luxus erziehen konnte, wie ich es vermochte...*<sup>23</sup>
- (5.a) *Por ti do të më pyetesh, ndoshta, se si munda, ta rris këtë fëmijë me këtë mirëqenie,se si arrita t'ia siguroj.....*<sup>24</sup> (si ja lejova vetës...)
- (6) *Tani mundësia e provokimit kaloi, dhe ai mund të ndiqte i shkujdesur zhvillimin e dasmës dhe mund të pinte sa të donte.*<sup>25</sup>
- (6.a) *Er konnte unbekümmert den weiteren Fortgang der Feier verfolgen und trinken, sowiel er wollte.*<sup>26</sup>

Kur foljet modale **können** përdoret me një pjesëz të mohores në shumicën e rasteve përdoret në gjuhën shqipe pjesëza **dot**:

- (7) *Am nächsten Tag zogst Du ein, aber trotzallem Spähens konnte ich Dich nicht zu Gesicht bekommen-Das steigerte nur meine Neugier.*<sup>27</sup>
- (7.a) *Të nesërmen ti erdhe, por, megjithëse, të përgjova, s'të pashë dot-kjo ma shtoi edhe më tepër kureshtjen.*<sup>28</sup>
- (8) *Margën e kisha dashur tërë jetën, asnjë grua tjetër nuk e kishte zënë dot vendin e saj.*<sup>29</sup>
- (8.a) *....dass,ich Marga mein Leben lang geliebt habe und dass keine andere Frau sie von irem Platz hätte verdrängen können.*<sup>30</sup>

<sup>18</sup> Kadare.I : *Der General der toten Armee* 1977:11

<sup>19</sup> Zweig ,S.: *Brief einer Unbekannten*, 1996: 162

<sup>20</sup> Zweig, S: *Letra e një të panjohure* 1989: 288

<sup>21</sup> Kadare .I : *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, 1980:139

<sup>22</sup> Kadare .I : *Der General der toten Armee* 1977:134

<sup>23</sup> Zweig ,S.: *Brief einer Unbekannten*, 1996: 186

<sup>24</sup> Zweig , S: *Letra e një të panjohure* 1989: 315

<sup>25</sup> Kadare.I : *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, 1980:206

<sup>26</sup> Kadare .I : *Der General der toten Armee* 1977:203

<sup>27</sup> Zëig,S.: *Brief einer Unbekannten*, 1996: 159

<sup>28</sup> Zëig , S: *Letra e një të panjohure* 1989: 284

<sup>29</sup> Kongoli ,F.: *Lëkura e qenit*, 2005: 11

<sup>30</sup> Kongoli,F.: *Hundehaut*, 2006: 13



## 5.2. Përdorimi i foljeve modale *können* dhe *mund* me modalitet epistemik

### Supozimin

- (9) *Vielleicht kann ich nicht ganz deutlich zu Dir sprechen, vielleicht verstehst Du mich nicht...*<sup>31</sup>
- (9.a) *Ndoshta s' do të mundem të flas fare qartë me ty, ndoshta ti s'po më kupton...*<sup>32</sup>
- (10) *"Sa i bukur që është!" Dhe ndoshta s'u besohej që e keqja mund të vinte andej.*<sup>33</sup>
- (10.a) *"Wie schön!" und wollten es gar nicht glauben, dass das Böse von dort gekommen sein könnte.*<sup>34</sup>

Nga shembujt del se foljet modale *können/mund* përputhen tërësisht si në përdorimin e tyre me modalitet joepistemik, ashtu edhe në përdorimin e tyre me modalitet epistemik,

## 6. Përfundim

Si përfundim i këtij punimi mund të thuhet se Selman Riza ka meritën e pamohueshme që arriti ta shndërrojë modalitetin e foljeve dhe gjegjësisht foljet modale në objekt studimi, ndërsa e pati filluar këtë studim me ndarjen e modaliteteve, duke u bazuar në gjuhëtarët e huaj (gjermanë etj.) dhe analogjinë e studimeve të tyre me gjuhën shqipe. Por fatkeqësisht nuk gjeti mbështetje. Shpresoj që në të ardhmen do të ketë studime edhe më të gjera për modalitetin jo vetëm tek foljet modale, por edhe te pjesët e tjera të ligjëratës, përmes të cilave shprehen keto modalitete. Gjuhësia shqiptare ka shumë nevojë për studime të tilla.

## Literatura

1. Agalliu, F./Angoni, E./Demiraj, Sh./ Dhrimo, A./ Hysa, E./ Lafe, E. Likaj, E. (1995), *Gramatika e gjuhës shqipe Vëllimi I, Morfologjia*, Tiranë.
2. Beci, B. (2005), *Gramatika e gjuhës shqipe për të gjithë*, Shkodër.
3. Buchholz, O./ Fiedler, W. (1987), *Albanische Grammatik*, Leipzig.
4. Hesse, H. (2003), *Siddharta*, Leipzig.
5. Hesse, H. (2005), *Siddharta*, Prishtinë 2005: 105.

<sup>31</sup> Zëeig, S.: *Brief einer Unbekannten*, 1996: 197

<sup>32</sup> Zëeig, S: *Letra e një të panjohure* 1989: 279

<sup>33</sup> Kadare .I : *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, 1980:166

<sup>34</sup> Kadare .I : *Der General der toten Armee* 1977:163

6. Kadare, I. (1977), *Der General der toten Armee*, Berlin.
7. Kadare, I. (2005), *Gjenerali i ushtrisë së vdekur*, Prishtinë.
8. Karapinjalli, M. (2003), Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, 21/2.
9. Kongoli, Fatos (2005), *Lëkura e qenit*, Tiranë.
10. Kongoli, Fatos (2006), *Hundehaut*, Zürich.
11. Newmark, L./ Hubbard, Ph./ Prifti, P. (1980), *Standard Albanian*. Stanford.
12. Riza, Selman (1997), *Sistemi foljor i letrarishtes shqiptare bashkëkohore*, Vepra 2, Prishtinë.
13. Zweig, Stefan (1989), *Novela*, Prishtinë.
14. Zweig, Stefan (1996), *Praterfrühling Erzählungen*, Frankfurt.